



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 124/2013
Prishtinë, më 22.11.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi, anëtarë.

Munguan: Sala Berisha - Shala, Ramiz Kelmendi dhe Shaip Muja.

Pjesëmarrës të ftuar: Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ramadan Sejdiu, drejtor i Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi- ZPRK, Dardan Abazi - INDEP dhe Berat Thaçi-GAP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.11.2013;
3. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
4. Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012;
5. Të ndryshme.
- 6.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 12.11.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit te Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me nivelin e zbatimit te Ligjit për Ndërmarrjet Publike;

Kryetari, tha se në bazë të planit të veprimit dhe agjendës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, e ka paraparë që për nivelin e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, të ftohet për të raportuar edhe z. Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me ç'rast ia dha fjalën ministrit Fadil Ismajli, për t'a paraqitur para komisionit, nivelin e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me këtë rast njoftoj në mënyrë kronologjike për punën dhe veprimet që janë ndërmarrë nga MZHE-ja, për zbatimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, duke thënë se në pjesën më të madhe, Ligji për Ndërmarrjet Publike po gjen zbatim në praktikë. Qeveria e Kosovës i ka miratuar edhe disa akte nënligjore, ndërsa ka formuar njëkohësisht edhe Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, si dhe ka aprovuar disa rregullore. Në vijim ai foli edhe rreth çështjes së zgjedhjes së organeve nga ana e ndërmarrjeve publike, siç janë drejtorët, bordet, ndërsa në fushën ligjore, ato kanë miratuar statutet e tyre, si dhe Kodin e Etikës. Z. Ismajli tha se ndërmarrjet publike bëjnë edhe raporte të rregullta periodike të veprimtarisë së tyre, që i dedikohen Qeverisë së Kosovës dhe njoftoi se te anëtarët e Komisionit, është duke u planifikuar ndryshimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, për të mundësuar një mbikëqyrje më të madhe të ndërmarrjeve publike, e që do të mundësojë edhe një performancë në dobi të shërbimeve më cilësore për qytetarët duke shtuar se kjo do të mundësojë përcaktim më të mirë të kompetencave, të kriterëve të zgjedhjes së menaxhmentit sa më të mirë, si nga ana menaxheriale, ashtu edhe nga ana etike.

Në përmbyllje të fjalës së tij, z. Ismajli tha se ka mund të bëhet më shumë në funksionalizimin dhe performancën e përgjithshme të ndërmarrjeve publike.

Visar Ymeri, parashtroi disa pyetje, që kishin të bëjnë me atë se a e përcakton Ligji ashtu si duhet nocionin se çka janë ndërmarrjet publike? Ndërmarrjet janë në pronësi të shtetit apo të publikut dhe kush është pronar në ndërmarrjet publike? Kush ka të drejt t'i themelojë ndërmarrjet publike? Për neni 9.1, të shitjes së aksioneve të NP-ve qendrore, siç është PTK-ja dhe shitja e transmisionit të KEK-u? A ka nevojë për plotësime të Ligjit në aspektin e dinamizmit të themelimit të ndërmarrjeve të reja publike? Më pas Ymeri theksoi se ka kohë që ka ndodhur skadimi i afateve të bordeve të NP-ve, dhe Qeveria ka marrë vendim për vazhdimin e afatit të këtyre bordove sepse Ligji aktual për ndërmarrjet publike nuk e rregullon këtë çështje, se a mund t'ju vazhdohen mandatet.

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pasi mori fjalën, ju përgjigj pyetjeve të shtruar. Për nocionin ndërmarrje publike, tha në esencë mund të quhet ndërmarrje publike sepse 100% i shërben publikut dhe është pronë publike, prandaj, nocioni publik ka të

bëjë më veprimtarinë që ju shërben publikut. Për themelimin e ndërmarrjeve të reja publike, tha se janë themeluar NP të reja, për të ofruar shërbime ma funksionale. Formimi i tyre është bërë për të mos lënë vakum në kryerjen e shërbimeve publike në të mire të qytetarëve. Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për NP, z. Ismajli tha se vetë fakti që po kërkohet ndryshimi i Ligjit, tregon se edhe elementi i dinamizmit do të gjejë vend në këtë Ligj. Kërkesa për plotësim ndryshimet e ligjit shihej edhe si një mundësi e evitimit të zgjedhjeve politike të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.

Për vazhdimin e mandateve të anëtarëve të bordeve për ndërmarrjet publike, tha që ka qenë për të mos lënë vakum në funksionimin e NP-ve. Ka qenë kërkesë e MZHE-së, që vendimi për përzgjedhjen anëtarëve të ri të bordit të bëhet pas zgjedhjeve lokale, pasi që mund të ketë ndikime politike përzgjedhje e tyre. Lidhur me këtë çështje, z. Ismajli tha se kriteret në konkurs kanë qenë mjaft të qarta dhe në pajtim me Ligjin. Për respektimin e nenit 9.1, për privatizimin e pronës, tha që paraprakisht duhet të merret vendimi i Kuvendit të Kosovës me Ligjin për Buxhetin e vitit 2011. Ndërsa, tha se shthurja e KEK-ut është bërë në aspektin e pavarësisë financiare funksionalizimin sa ma të mirë të furnizimit më energji elektrike.

Myzejene Selmani, - tha që pengesat që po shfaqen në Ligjin për Ndërmarrjet Publike janë disa kompetenca që kanë qenë në përgjegjësi të ICO-së dhe kur kanë kaluar këto kompetenca në Qeverinë e Kosovës, kanë kaluar në pako edhe këtu janë bërë disa lëshime, prandaj kjo është edhe një arsye së duhet të fillohet më plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Lutfi Zharku, pyeti për ndërmarrjet publike që janë në humbje siç janë: Aeroporti Kontrolli ajror (pjesa e pa koncesionuar), TrainKos, Ibër-Lepenci, si ju është aprovuar raporti nga Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike? Për privatizimin e Distribucionit të rrejtit elektrik të KEK-ut, çka konkretisht është privatizuar?

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për privatizimin e Distribucionit të KEK-ut, tha që është shitur një biznes i keq dhe është bërë blerja e aseteve të vjetruara që ekzistojnë e që janë shumë të amortizuara.

Ramadan Sejdiu, drejtor në Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, ju përgjigj pyetjeve: Për ndërmarrjet publike që janë në humbje, tha se arsyet e mosperformimit pozitiv financiar të këtyre ndërmarrjeve i shpjegoi si vështirësi në afarizëm. Ne rastin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, është barra financiare nga procesi i shpronësimit të tokave. Ndërsa, në rastin e “Ibër-Lepencit”, edhe pse kjo kompani ka përfunduar vitin me fitim operativ, kjo humbje financiare vjetore është rezultat i rritjes së kostos së zhvlerësimit të kapitalit (asetet) të vjetruara dhe kushteve jo të favorshme hidrologjike për gjenerim të energjisë elektrike. Duke folur për çështjen e auditimit, Sejdiu tha se është mjaft funksional, disa ndërmarrje madje kanë edhe ekipe auditorësh, por në disa raste kontraktohen edhe auditorë të jashtëm.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Grupi i Punës të vazhdojë me aktivitetet e parapara më Plan të Veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

4. Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012;

Kryetari, tha që do ta shqyrtojmë Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012, pas përmbledhjes së raporteve vjetore të ndërmarrjeve publike që e bënë Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, nga gjitha ndërmarrjet publike. Më pas fjalën ia dha z. Ramadan Sejdiu, drejtor në Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, për të paraqitur një ekspozë mbi Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012.

Ramadan Sejdiu, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik-Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, tha se Raporti është përpiluar nga të dhënat e ndërmarrjeve publike, zyra rregullative dhe raporteve të auditorëve të jashtëm, për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e ndërmarrjeve publike. Pastaj në mënyrë kronologjike paraqiti një ekspozë të Raportit të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012. Sejdiu theksoi që Raporti në fjalë paraqet të dhënat lidhur me performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2012, si dhe krahasimet me të dhënat e gjetura në vitin 2011. Ai tha se Njësia për Ndërmarrje Publike, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ka përgjegjësi ligjore të monitorojë dhe raportojë për performancën e ndërmarrjeve publike, me theks të veçantë për: performancën operative, performancën financiare, qeverisjen korporative dhe perspektivën për të ardhmen. Raporti tha, gjithashtu paraqet projektet dhe objektivat për vitin 2013, si dhe përmban rekomandime lidhur me ndryshimin e politikave dhe veprimeve përkatëse, për përmirësimin e performancës të këtyre subjekteve. Ai tha se në korrik të këtij viti, pas shqyrtimit nga ana e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike, raporti është dërguar për komente në ministritë, të cilat e përbëjnë Komisionin Ndërministror. Ai theksoi se raporti përbehet nga tri pjesë kryesore: Pikëpamje mbi funksionimin e qeverisjes së korporatave dhe funksionimit të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, për vitin 2012; Performancën sipas sektorëve, subvencionimin e ndërmarrjeve publike dhe performancën financiare në përgjithësi të ndërmarrjeve publike. Rezultatet dhe gjendja në ndërmarrjet publike paraqesin: vizionin, misionin, objektivat, projektet, perspektivën, dhe sfidat. Në fund, theksoi se raporti i këtij viti, dallon nga vitet e mëparshme, ngase këtë vit hartimi i raportit është mbështetur nga këshilltarët ndërkombëtarë të sponsoruar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim Ekonomik. Prandaj, raporti paraqet një përmbledhje të kujdesshme të të dhënave të verifikuara dhe të analizuar, përfshirë edhe rekomandimet për avancim të performancës së ndërmarrjeve publike.

Hashim Deshishku, pyeti për faqen 12 të raportit për performancën financiare të PTK-së, pse është dividenda më e madhe se fitimi? Dhe pse KEK-u merr subvencione prej Qeverisë dhe mandej del në fitim? Ndërsa, për ndërmarrjet e ujësjellësit, tha që është më mirë të kalojnë në ndërmarrje komunale dhe të menaxhohen nga komunat, për shkak se rrjetin e shtrirjes së gypave dhe kanalizimit pothuajse pjesën më të madhe të këtyre punëve po e realizojnë komunat.

Fikrim Damka, pyeti për Ndërmarrjen KOSTT, se pse e ka shtuar numrin e punëtorëve?

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit ekonomik, u përgjigj në këtë pyetje duke thënë se për subvencionet në KEK, Qeveria i jep KEK-ut subvencion për t'i zvogëluar tarifat. Për rritjen e numrit të punëtorëve në KOSTT, tha që kur kemi numër në rritje të nënstacioneve për furnizim me energji elektrike, atëherë është dashur të rrisim edhe numrin e të punësuarve në KOSTT.

Ramadan Sejdiu, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, ju përgjigj pyetjes se pse është dividenda më e madhe se

fitimi në PTK. Ai tha, që ka pas shumë të madhe të parave në kesh dhe dividenda është ndarë në vitin 2011, për këtë arsye është përsërit si dividendë në vitin 2012.

Pas debatit, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i Performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti i Performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2012.

**5. Të ndryshme.
Çështjet vijuese.**

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti